



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT
NJËSIA E PROKURIMIT

Burrel, më _____._____.2022

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR –
MALLRA”**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Naftë Diesel (D1) dhe Benzinë pa plumb”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Naftë, Benzinë pa plumb

VLERA E FONDIT LIMIT:

**25 358 313 (njëzet e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë
pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Mat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2018, 2019, dhe 2020**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë sa vlera e përlllogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.
- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2018, 2019, dhe 2020**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2021** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, *ku nëse kualifikohet, përpara përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, sa vlera e përlllogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2018, 2019, 2020) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 40 % të vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 4** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 4** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkoni**” nënkupton se këto kritere janë detyrues, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërme.

Njësia përcaktoj kritere për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 40 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë për stacionin e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 dhe VKM-së Nr.970, datë 02.12.2015 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*” (i ndryshuar).

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;**

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5** e vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor **kërkoni**:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Në ligjin **Nr.8450, datë 24.02.1999** “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” (i ndryshuar), përcaktohet se, citojmë:

Kreu II “Personat juridikë, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, **Neni 11** - Personat juridike, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:... **ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete;**

Neni 15 “Stacionet e shitjes së karburanteve”, **1. Veprimtaria e tregtimit me pakicë të karburanteve, ku përfshihen nënproduktet e kategorisë I, II dhe III, të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, ushtrohet nga stacionet e shitjes së karburanteve.**

Stacionet e shitjes së karburanteve janë persona juridike, që themelohen në një nga format e shoqërive të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji, me kusht që ndertimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë të jenë në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga ministria.

KREU III “Leja e koncesionit, leja e tregtimit, autorizimet dhe procedura e dhenies së tyre”, **Neni 17** - Personat juridike që ushtrojnë veprimtari të përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës bruto, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse janë të detyruar të pajisen me leje koncesioni, leje tregtimi ose autorizimi.

Neni 20 “Autorizimet” **1. Autorizimet u jepen personave juridike, të parashikuara në pikat "ç" dhe "d", të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lendeve djegëse (njësitë e shitjes së lendeve djegëse).**

2. Autorizimet për personat juridike, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Autorizimet për personat juridike, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostradë, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhenien e autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave me **Nr.970, datë 02.12.2015** “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar), parashikohet se, citojmë: **“II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.**

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Ministri që mbulon veprimtarinë e transportit rrugor, kur stacioni i karburanteve do të ndërtohet në autostradë;

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

2. Për marrjen e licencave për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete e vajrave lubrifikante, personi juridik duhet të paraqesë, pranë organit që ka të drejtën e dhënies së licencës, këto dokumente: e) Autorizimin hyrjedalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës;

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit vlerëson se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacionin (liçencën për tregtimin me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë) e kërkuar, me qëllim verifikimin se operatorit ekonomik është i liçensuar për tregtimin e me pakicë të karburanteve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për kapacitetin profesional të ushtrimit të veprimtarisë si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, të operatorëve ekonomikë për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) pikë furnizimi me vendodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj). Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore, Vërtetim Teknik nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Akt-Teknik nga PMNZH, dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për shitjen me pakicë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitin 2021.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rastin kur nuk është shoqëri tregtuese me shumicë, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar të furnizimit me një shoqëri e cila është e liçencuar për tregtimin me shumicë të produktit që prokurohet.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga një shoqëri e akredituar, Leje Mjedisore të lëshuar nga QKL, Akt-Teknik të lëshuar nga PMNZH, dhe Policë Sigurimi lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese jo më pak se 40 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

2.3.7 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij, dhe/ose të furnizuesit të produktit, për produktin **Diesel 10 PPM S SH EN 590:2017 dhe Benzinë pa plumb S SH EN 228:2012 + A1:2017 ose ekuivalente me to, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është laborator i huaj duhet e përkthyer dhe e noterizuar në shqip), që vërteton cilësinë e produktit objekt i kësaj kontrate që ofertuesi tregton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar jo më parë se muaji Shkurt 2022.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) **aftësinë teknike dhe profesionale;**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5** dhe **8** e Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i normave juridike vlerëson se edhe këto kritere janë të detyrueshme për t’u vendosur në DST. Fjala “**kërkon**” nënkupton se këto kritere janë kritere detyrues edhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e prokurimit me objektin e mësipërm.

1. Kriteri i vendosur për disponimin e 1 (një) pikë furnizimit/ stacion shitje është i domosdoshëm për furnizimin e automjeteve të autoritetit kontraktor me mallin objekt prokurimi, ku duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor të kërkuar për vërtetimin e disponimit të tij, referuar nenit 15 të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin,

transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” dhe Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar).

2. Me qëllim vërtetimin e besueshmërisë të operatorit ekonomik pjesëmarrës se ai ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqipëtar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje cilësie, në mbështetje të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 *“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”* dhe akteve nënligjore, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 *“Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”*, Urdhërit të Ministrit Nr.06, datë 09.01.2015 *“Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”*, Njësia e prokurimit vlerëson se operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e kërkuar, lëshuar nga ISHTI.
3. Në zbatim të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”* neni 15 pika 2 të tij, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë në rastin kur nuk është shoqëri tregtuese me shumicë, duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar të furnizimit me një shoqëri e cila është e licencuar për tregtimin me shumicë të produktit që prokurohet.
4. Po ashtu, me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik disponon kapacitete teknike/depozituese lidhur me rezervat e tij për të garantuar vazhdimësi në furnizimin e autoritetit kontraktor me produktin objekt prokurimi, në mbështetje të të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”*, ligjit Nr.10448, datë 14.07.2011 *“Për lejet e mjedisit”* (i ndryshuar me ligjin nr.52/2020) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.970, datë 02.12.2015 *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”* (i ndryshuar), Urdhërit nr. 315, datë 24.08.2017 *“Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”*, njësia e prokurimit gjykon se operatori ekonomik duhet të disponojë një kapacitet depozitues jo më pak se 40 m³, ku për vërtetimin e tij, duhet të paraqesë dokumentacionin ligjor të kërkuar.
5. Gjithashtu, në zbatim të ligjit Nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”* neni 23 i tij, VKM-së Nr.147, datë 21.03.2007 *“Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”*, si dhe Urdhërit të Ministrit Nr.06, datë 09.01.2015 *“Për kontrollin e standarteve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse”*, me qëllim verifikimin se produktet që operatori ekonomik oferton **Diesel 10 PPM** dhe Benzinë pa plumb, janë sipas standarteve **S SH EN 590:2017 (Diesel 10 PPM)** dhe **S SH EN 228:2012 + A1:2017 (Benzinë pa plumb) ose ekuivalente me to, të njohur nga Standartet Shqipëtare** të kërkuar në dokumentat standarte të procedurës së prokurimit, Njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet që të paraqesin fletë-analizën e kontrollit të kryer në stacionin e tij për secilin produkt, lëshuar nga organi kompetent ose nga një laborator shqiptar ose i huaj, sipas

standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike e lëshuar jo më parë se muaji Shkurt 2022

Kapacitetet dhe dokumentacioni ligjor i kërkuar, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur duhet të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacion të shitjes së karburantit me pakicë në pistoletë publike me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, deri në përfundim të Kontratës dhe me vendndodhje në Njësinë Administrative Burrel/ Bashkia Mat me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona në formë biletash, në adresën e kërkuar dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme për periudhën, vitet 2022-2024.
- Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.
- Disponimi/ Ekzistenca e ndërfaqes së menaxhimit të karburantit (webpage), së bashku me ofrimin shërbimeve të kërkuara mësipër, do të demonstrohen nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës me shembuj për zbatimin në praktikë, në prani anëtarëve të KVO-së së Autoritetit kontraktor përpara mbylljes së procesit të kualifikimit dhe shpalljes së fituesit.

Mosofrimi i Ndërfaqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë

kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale;**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se **operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në **nenin 40** “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” **pika 5** dhe **8** e Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit me anë të këtij kriteri kërkon që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se marrin përsipër furnizimin e produktit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, dhe disponojnë ndërfaqe të menaxhimit të karburantit (webpage) për sigurimin e shërbimit të furnizimit me karburant në zbatim të VKM-së Nr. 561, datë 29.07.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriterin për aftësinë teknike si më lart duke qënë se ky kriter është i detyrueshëm, është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërben autoritetit tonë kontraktor për njohjen se, vërtetë operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë aftësitë e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në Relacionin e paraqitur nga Komisioni i ngritur për përcaktimin e F. Limit dhe Specifikimeve Teknike, ku bashkëlidhur ka dërguar specifikimet teknike të mallrave/ produkteve (naftë dhe benzinë pa plumb) objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për mallin objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 24.03.2022, ora 10.⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al .**

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT